

V E N D I M
Nr.460, datë 22.7.1998

PËR AKSIDENTIN NË PUNË

Në mbështetje të nenit 14 paragrafi 3 të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Aksident në punë është dëmtimi i menjëhershëm i punëmarrësit gjatë kryerjes së punës ose gjatë një procesi që ka lidhje me punën, i cili çon në humbjen e përkohshme ose të përhershme të aftësisë për punë ose dhe në vdekje.

2. Aksidenti konsiderohet se ka ndodhur në punë ose gjatë një procesi që ka lidhje me të kur:

- a) punëmarrësi dëmtohet gjatë punës së zakonshme;
- b) punëmarrësi dëmtohet gjatë kryerjes së një pune tjetër, pa urdhër të punëdhënësit, por për arsye madhore në interes të punës;
- c) punëmarrësi dëmtohet gjatë kryerjes së një pune tjetër, me porosi të punëdhënësit;
- d) punëmarrësi dëmtohet gjatë kohës së pushimit, në vendin e caktuar për pushim ose për vënie në rregull të makinerive, veglave, veshmbathjeve, para ose pas mbarimit të punës;
- e) punëmarrësi dëmtohet gjatë rrugës, në linjën e drejtpërdrejtë, nga banesa për në punë dhe anasjelltas, si në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësi edhe kur ai është individual.

3. Në rastet e një aksidenti në punë, që shkakton vdekjen e punëmarrësit ose dëmtime të rënda masive, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, pas dhënies së ndihmës së parë, duhet të ruajë provat materiale që i shërbejnë analizimit të shkaqeve të aksidentit dhe të lajmërojë menjëherë organet e prokurorisë, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Në rast aksidentesh të tjera, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, të lajmërojë brenda 3 ditëve Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

5. Aksidenti në punë deklarohet me anë të procesverbalit, i cili mbahet në vendin e ngjarjes dhe duhet të firmoset nga punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, si dhe nga inspektori i punës.

6. Forma e procesverbalit dhe udhëzimet përkatëse për plotësimin e tij përcaktohen nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

7. Shkelja e pikave 3 dhe 4 nga punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, dënohet sipas kreut VIII të "Procedura dhe sanksione", të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

